

S T A T U T

--I SHOQERISE PRIVATE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR (SH.P.K.) "CEPELE"

Ne meshtetje te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerit Tregetare", une i quajhuri Vezir Cepele, i biri i Saliut dhe i Sherines i dt. 1953, lindur ne Jagodine dhe banues ne Roskovec, me zotesi te plote juridike per te vepruar, shpall sa me poshte vijon:

FORMIMI I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "CEPELE"

Neni 1

Formohet shoqeria private tregetare e quajtur ;"CEPELE", shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.), nga z. Vezir Cepele (Ortaku i vetem), qe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres ne kapitalin themeltar.

Neni 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise eshte ne kete adrese: Vezir Cepele Roskovec Fier. Shoqeria mund te hap edhe vendqendrim te tjera te dyta, operative dhe filjale ne teritorin e Republikes se Shqiperise.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ekonomike mbi dhjete vjet te njepasnjeshme e larte.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4

Objekti i shoqerise eshte:
Pike shperndarje karburantesh, vajrash dhe pjese kembimi automjetesh.

Neni 5

Shoqeria private "CEPELE" mund te ndryshoje emertimin e saj, seline dhe Objektin e veprimtarise se saj, sipas vendimit qe do te marre Ortaku i Vetem themelues i saj.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte ne shumen 100.000 lek e shprehur ne natyre nje ndertese (pike karburanti) dhe i vene nga ortaku i vetem Vezir Cepele.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 7

Ortaku i Vetem qe eshte dhe Drejtori i saj, sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, emron administratoret, keshillin administrativ si dhe puneson puntore te aktiviteteve te ndryshem.

Neni 8

Ortaku i Vetem percakton drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise si dhe drejton, organizon e kontrollon kete veprimtari. Miraton planin ekonomik-financiar, bilancet, deklaratat e ndryshme, si dhe merr masa te ndryshme per plotesimin e kerkesave te parashikuara ne dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 9

Ortaku i vetem miraton rregulloren e brendeshme te aktivitetit te shoqerise, strukturen organizative, lidhe kontrata me te tretet dhe vendose per zgjidhjen e tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 10

Ortaku i vetem vendos per marrjen e kredive dhe perdorimin e tyre.

Neni 11

Ortaku i Vetem lidh kontrata individuale dhe kolektive te punes sipas rastit, per realizimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin e punes dhe statutin e shoqerise te cilat jane te detyrueshme per tu zbatuar.

Neni 12

Perfaqesimi i Shoqerise i perkete Ortakut te vetem (Drejtorit), si dhe administratorëve ne rastet e autorizuar.

Drejtori dhe administratorët kane te drejte te perfaqesojne shoqerine ne organet gjyqesore vete ose nepermjet avokateve te caktuar prej tyre, sipas rastit si dhe ne organet e ndryshme shtetore.

Neni 13

Mosmarveshjet qe mundee te lindin midise shoqerise dhe te punesuarve zgjidhen nga gjykata.

Neni 14

Shoqeria ka vulen e sajme me madhesi te zakoneshme ne te cilen shkruhet: Shoqeria private "CEPELE" (SH.P.K.) Fier.

Neni 15

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar dhe emrat e Ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjera nga kjo shoqeri qe ju drejtohet te treteve.

Neni 16

SEKRETI I PUNES

Konsiderohen si sekrete te punes te kesaj shoqerie te gjitha aktet dhe dokumentat qe jane vendosur nga Ortaku i vetem i shoqerise (Drejtori).

KONTROLLI I BRENDSHEM

Neni 17

Shoqeria organizon kontroll te brendshem me eksperte kontabel te autorizuar dhe te emruar me afate te caktuar ose te pa caktuar.

~~Neni~~
BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 18

Shoqeria nderton veprimtarine ekonomiko-financiare mbi bazen e leverdise ne kushtet e ekonomise se tregut te lire, mbeshtetur ne kapitalin baze, ne fondin themeltar e mjetet e xhiros, mundesin e kreditimit dhe huazimit nga shteti apo persona te tjere juridik e fizike brenda e jashte shtetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe mundesine e zhvillimit te investimeve etj.

Veprimtaria ekonomike kryhet ne vazhdimesi dhe gjen pasqyrimin e saj ne bilancin periodike perkates.

Neni 19

Shoqeris ka llogarine e saj ne Banken e Shtetit dhe mund te hap edhe ne vende te tjera nepermjet te cilave kryen veprimet e saj bankare.

Neni 20

Ne bilancet periodike pasurit e saj pasqyrohen te shprehura ne monedhe shqiptare dhe sipas rastit edhe ne monedhe te huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republikën e Shqiperise. Mbi bazen e ketij legjislacioni shoqeria percakton edhe format e bilanceve e te llogarive per dokumentimin e veprimtarise se saj ekonomiko-financiare.

Neni 21

Shoqeria kur e vlereson te perligjur mund te investoje ne ndermarje, shoqeri e persona te tjere juridik e fizike vendas e te

huaj kapitalet e ~~tyrre~~ saj.

Neni 22

Shoqeria zbaton ligjet e kontabilitetit dhe regullat ne fuqi, harto programin financiar vjetor dhe organizon sherbimin statistikor perkates.

Neni 23

Si person juridik Shqiptar shoqeria gezon te drejten e transferimi te kapitalit e te fitimit edhe jashte shtetit ne baze te rregullave te caktuara.

Neni 24

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirishte te transferushem ne rruge trashegimie, ndarje pasurore medis bashkeshorteve si dhe midise parardhesve e pasardhesve.

Neni 25

Perdorimi i fitimit eshte* kopetence eskluzive e Ortakut te vetem, i cili vendos per perdorimin e tij e per krijimin e fondit rezerve.

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 26

Shoqeria ndryshon organizimin e saj ne formen e shperndarjes si dhe pushon veprimtarine e saj ne formen e likujdimit.

Shoqeria pushon veprimtarine e saj ne keto raste:

- Ne rastet e parashikuara ne ligj.
- Ne rast ndarje, bashkimi apo pamundesie per te vazhduar veprimtarine e saj.
- Me urdher te organit kopetente si rrjedhoje e shkeljes se ligjit.
- Kur perfundon qellimin per te cilin eshte krijuar.

Me kete raste shoqeria krijon komisjonin e likujdimit i cili praqet bilancin e likujdimit.

Mbasi mbyllet shoqeria, ajo kryen te gjitha veprimet dokumentare te nevojeshme dhe veprimet e duhura per cregjistrimin nga regjistri tregetar.

Neni 27

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut si dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne regjistrin tregetar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, ndersa ushtron aktivi-

tatin e saj ekonomik me regjistrimin si subjekt privat ne organin
perkatues tatimor.

Neni 28

Ky statut hynë ne fuqi dite e nenshkrimet nga Ortaku themelues
i shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

"GEPELE"

(Vezir Gepele)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE PIER
Nr. 4480 Rregj.

Fier, me 10/6/ 1994

V E R T E T I M

Vertetohet se statutimi mesiperme eshte firmosur ne prezencen ti.
me prej z. Vezir Gepele, i biri i Saliut dhe i Sherines, i dt. 1953,
lindur ne Jagodine dhe banues ne Roskovec, me zotesi te plote juridike
per te vepruar, i identifikuar me Leternjoftimin EV Nr. 437540.

NOTERJA

(Arjana Dodi)

